



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
ADMINISTRATOR

URDHËR

NR 56 , DATË 13/11/2020

MBI

**“FILLIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË  
DOKUMENTACIONIT, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË  
ARTEVE, PËR STUDENTËT TË CILËT DO TË APLIKOJNË PËR TË PËRFITUAR  
PËRJASHTIM OSE REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR  
VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË UART**

Në zbatim të nenit 112 të Ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; VKM Nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); VKM nr.251 datë 27.03.2020 “Një ndryshim në KVM nr.269, datë 29.03.2017 për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”; VKM Nr.780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ

1. Fillimin e procedurës për pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve për studentët që do të aplikojnë për të përfutuar përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2020-2021;
2. Punonjësit që do të merren me administrimin e procesit në çdo fakultet, do të jenë si më poshtë:
  - Nermin Zebi (Fakulteti i Muzikës), [nermin\\_zebi@yahoo.com](mailto:nermin_zebi@yahoo.com);
  - Arta Dashi (Fakulteti i Arteve të Bukura), [arta\\_dashi@yahoo.com](mailto:arta_dashi@yahoo.com);
  - Enela Mastori (Fakulteti i Artit Skenik), [enelamastori@yahoo.com](mailto:enelamastori@yahoo.com)
3. Studentët duhet të aplikojnë online, duke dorëzuar dokumentacionin sipas formulareve (bashkëlidhur) të skanuara në adresën elektronike të fakultetit përkatës, duke filluar nga data **13/11/2020**;





4. Studentët brenda më datë **4 Dhjetor 2020**, përveç aplikimit online duhet të dorëzojnë fizikisht të gjithë dokumentacionin (të cilin kanë dorëzuar paraprakisht online). Dokumentacioni i dorëzuar fizikisht do të shoqërohet me proces verbal sipas formatit bashkëlidhur firmosur nga studenti dhe përfaqësuesi i Fakultetit përkatës;
5. Grupi i punës në Fakultete ka për detyrë të pranojë dhe shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); VKM nr.780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”;
6. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit, në zyrën e protokollit në Rektorat, nga Grupi i punës është data **11.12.2020**;
7. Personat përgjegjës në fakultet të regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të vecantë dhe mbasi të shqyrtojnë dokumentacionin e paraqitur nga studentët, përcaktojnë studentët që përfitojnë ose jo përjashtim apo reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2020-2021. Materiali i përgatitur duhet ti dergohet dhe ja përcjell për verifikim Sektorit Juridik;
8. Pas verifikimit të dokumentacioni të Grupit të punës nga Sektori Juridik, përgatitet Informacioni për Administratoren e Universitetit të Arteve;
9. Afati përfundimtar për mbarimin e punës nga ana e grupit të punës dhe Sektorit Juridik është data **14/12/2020**;
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri grupi i punës, Dekanët, Sekretaritetë në Fakultete, Sektori Juridik, Zyra e protokollit pranë Universitetit të Arteve dhe sektori i IT.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë**

**Msc. Alma Sinanaj**

**ADMINISTRATOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE**

